



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 18.2.2025

Nr: 110

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E RAPORTIT MBI VEPRIMTARITË PUBLIKE PËR PERIUdhËN 09
SHKURT-15 SHKURT 2025**

Sot, më datë 18.2.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

OBJEKT: Shqyrtimi i raportit mbi veprimtaritë me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 09 shkurt deri më 15 shkurt 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

V E N D O S:

1. Miratimin e raportit të gjetjeve mbi veprimtaritë publike për periudhën 09 shkurt deri më 15 shkurt 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
3. Fillimin e procedimit administrativ ndaj KESH sh.a.
4. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Data: 18.2.2025 Nr. 110
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e raportit mbi veprimtaritë publike për periudhën 09 shkurt – 15 shkurt 2025”

5. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI



Tiranë më	
Nr.	prot.

RAPORTI I GJETJEVE

MBI

VEPRIMTARITË ME KARAKTER PUBLIK TË DISA INSTITUCIONEVE, PËR PERIUDHËN 09 SHKURT-15 SHKURT 2025

Në lidhje me raportimet e veprimtarive publike në Ndërfaqen e Raportimeve të Institucioneve (NRI), për periudhën 09 shkurt-15 shkurt 2025, konstatohet si vijon:

- 12 institucione publike të reja janë regjistruar gjatë kësaj periudhe në NRI, dhe kanë akses për raportimin e veprimtarive,
- **292 raportime** janë kryer në total,
- 283 postime janë aktive,
- **9 veprimtari janë ndaluar automatikisht nga sistemi për shkak të raportimit jashtë afati**-nga të cilat për 4 veprimtari do fillojë shqyrtimi administrativ dhe 5 veprimtari nuk janë në kushtet e kundërvajtjes administrative pasi e kanë riraportuar veprimtarinë brenda afatit.

Për datat **09 shkurt-15 shkurt 2025**, në ndërfaqen e raportimeve janë ndaluar 9 veprimtari të raportuara nga institucione, për shkak të tejkalimit të afatit ligjor, si më poshtë vijon:

1. **Bashkia Korçë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve një veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
 - "Aktivitete nga Korça Innovation Hub (Sektori i Teknologjisë së Informacionit), Bashkia Korçë", raportuar në datë 10.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 14.02.2025.

Personi përgjegjës për raportimet ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike se: "Ka ndodhur një lapsus në përlllogaritjen e ditës së veprimtarisë, duke filluar numërimin e 5 ditëve, që nga e hëna, datë 11.02.2025. Gabimin e kuptuar, e kemi reflektuar në raportimin e aktivitetit dhe realizimin e tij të hënën në datën 17.02.2025".

Nga verifikimet e kryera rezulton se veprimtaria është riraportuar në datë 10.2.2025 për tu zhvilluar në datë 17.2.2025. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

2. **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve një veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
 - "Panairi i Turizmit", raportuar në datë 10.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 12.02.2025.

- 3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kolonjë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve një veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
-"Analizë vjetore", raportuar në datë 09.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 12.02.2025.

Personi përgjegjës për raportimet ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike se: "Gabimisht gjatë aplikimit u përzgjedh data e zhvillimit gabim. Për këtë arsye u ripërsërit kërkesa për në datën 14.02.2025".

Pasi u verifikua faktet e paraqitura prej ZVAP Kolonjë rezulton se Veprimtaria është riraportuar për t'u zhvilluar në datë 14.2.2025. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

- 4. KESH sh.a** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve një veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:

- "Rikonstruksioni i rrugës Qafë-Qelë-Koman", raportuar në datë 10.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 10.02.2025.

- 5. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve dy veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematika si më poshtë vijon:

- Inspektim në repartet Ushtarake Korçë, Mjekës, Mirakë, raportuar në datë 10.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 13.02.2025,
- Mbyllja e Kursit 'Stërvitje individuale Bazë', raportuar në datë 10.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 14.02.2025.

- 6. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve dy veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematika si më poshtë vijon:

1. "Takim me të miturin në proces rehabilitimi", raportuar në datë 14.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 14.02.2025, ora 11:00
2. "Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të javës së mbrojtjes së viktimave të krimit", raportuar në datë 14.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 14.02.2025, ora 10:00.

Personi përgjegjës për raportimet ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike se: "Është konstatuar për aktivitetet e raportuara nga ana jonë për datën 18 shkurt se është shënuar si i ndaluar për shkak të afateve të paracaktuara me dispozitat ligjore dhe për këtë arsye do të anulohet aktivitetin dhe ta zhvillojmë në një datë tjetër".

Pasi u verifikuan faktet e paraqitura prej Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve rezulton se veprimtaritë janë riraportuar për tu zhvilluar në datë 20.2.2025, brenda afatit ligjor të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, i ndryshuar. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

- 7. Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve një veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:

- "Xhirim klipi për sensibilizimin e katërputroshëve tek Lulishtja në qendër të Kryeqytetit", raportuar në datë 14.2.2025 për t'u zhvilluar në datë 14.2.2025 ora 11:00.

Për shkak të tematikës së veprimtarisë, nuk hyn në kategorinë e veprimtarive publike që mbartin detyrim për raportim. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

KQZ është në monitorim të vazhdueshëm të këtij procesi dhe në vijimësi do duhet që të gjithë institucionet shtetërore të kryejnë raportimet në lidhje me veprimtaritë që planifikohen të zhvillohen prej tyre, të paktën 5 ditë para zhvillimit të tyre dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.